

# HAPËSIRAT

SHTATOR

2020

# PUBLIKE GJELBËRUESE

PRIZREN



EC Ma Ndryshe

# HAPËSIRAT PUBLIKE GJELBËRUESE NË PRIZREN

Autor dhe botues: EC Ma ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &  
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi “Hapësirat publike gjelbëruese në Prizren” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF. Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

Shtator, 2020

# HYRJE

Hapësirat e gjelbra si pjesë esenciale të cilat luajnë rolin e mushkërive të qytetit janë të mangëta në zonën urbane të Prizrenit. Për vite me radhë qytetarët e Prizrenit dhe EC kanë ngritur zërin e tyre rreth këtij shqetësimi mirëpo ky problem ende vazhdon të mbetet aktual. Mungesa e hapësirave të gjelbra ka një numër pasojash për një komunitet pasi që i privon ata nga hapësira për socializim dhe i ekspozon ata ndaj zhurmës, ajrit të ndotur dhe temperaturave të larta gjatë verës.

Viteve të fundit, qasja ndaj hapësirës publike gradualisht ka ndryshuar duke rizbuluar rëndësinë e tyre si pjesë integrale e identitetit urban të qyteteve. Për qytetet është me rëndësi që të kenë një strategji të suksesshme të rigjenerimit urban dhe të veprojnë si shembuj për inkurajimin e qyteteve të tjera në rajon për të rimenduar dhe riinvestuar në cilësinë e hapësirave publike. Kjo rritje e interesit ndaj hapësirave publike është një hap përpara drejt përmirësimit të cilësisë së jetës publike të njerëzve në botë, interesim ky që në qytetin e Prizrenit ka munguar për një kohë të gjatë. Ky fakt mbështetet edhe nga të gjeturat e realizuara nga hulumtimi "Hapësirat publike gjelbëruese".


EC Ma Ndryshe ka realizuar këtë hulumtim me qëllim që të merret një vlerësim direkt nga qytetarët mbi kualitetin e shfrytëzueshmërisë së hapësirave të cilat janë në dispozicion.

Disa nga çështjet që janë shtjelluar në kuadër të këtij studimi janë qasja e personave me aftësi të kufizuara nëpër hapësira publike, cenimi i sigurisë publike nga qentë endacak, siguria e grave në parqe, prania e mobilitetit urban, cilësia e ndriçimit publik dhe tema të tjera të cilat lidhen me kualitetin dhe sigurinë e hapësirave publike.

Numri total i të anketuarve është 122 persona, nga të cilët 58 gra dhe 64 burra.

Paraqitja grafike e të dhënave të hulumtimit është në vijim.


## 1. SA SHPESH I FREKUENTONI PARQET PUBLIKE ?



## PËRMBLEDHJE:

Shumica janë përgjigjur që rrallëherë i frekuentojnë parqet publike, gratë për një përqindje pak më të lartë se burrat dhe grupmosha 25-34 vjeç janë shprehur si frekuentues më të shpeshtë.


## 2. A MENDONI SE KA MJAFTUESHËM HAPËSIRA PUBLIKE TË GJELBËRUARA NË QYTET ?



## PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve, gjegjësisht 40% e tyre, janë shprehur se ka nevojë për më shumë hapësira publike të gjelbëruara, me prononcime të njëjta nga të dyja gjinitë dhe të gjitha grupmoshat ishin të të njëjtit mendim.


### 3. A KA HAPËSIRË GJELBËRUESE/PARK NË LAGJEN KU BANONI DHE NË ÇFARË GJENDJE ËSHTË ?



#### PËRMBLEDHJE:

49% e të anketuarve janë shprehur se ka hapësira gjelbëruese në lagjet e tyre, mirëpo nuk mirëmbahen, ndërkohë që 40% kanë thënë se nuk ka parqe në lagjet e tyre. Dallimi mes përgjigjeve të grave dhe burrave ka qenë shumë i vogël, ndërsa grupmoshat e reja janë shprehur më të pakënaqur nga gjendja e tyre.


### 4. CILA PJESË/LAGJE E QYTETIT MENDONI QË KA NEVOJË PËR HAPËSIRA GJELBËRUESE/PARK ?



#### PËRMBLEDHJE:

13.9% e qytetarëve janë shprehur se lagjja Bazhdërhane ka nevojë më së shumti për hapësira gjelbëruese/park, të ndjekur me 9.8% për lagjet Dardania përkatësisht Ortakolli. Burrat janë prononcuar më zëshëm në lidhje me këtë çështje, përderisa gratë më moderueshëm përgjithësisht. Grupmoshat më të reja i kanë parë më të nevojshme hapësirat gjelbëruese.


## 5. NGA KUSH FREKUENTOHEM MË SË SHUMTI PARKU NË LAGJEN TUAJ ?



## PËRMBLEDHJE:

Sipas statistikave, parqet nëpër lagje frekuentohen më së shumti nga fëmijët me prindër me 34%, duke u pasuar nga familjarët me 29%. Frenkuentimi nga dy gjinitë është pothuajse i njëjtë, ndërsa grupmoshat e reja janë shprehur si frekuentuesit më të mëdhenj.

## 6. A KA KËND TË LOJËRAVE PËR FËMIJË NË PARKUN TUAJ ?




## PËRMBLEDHJE:

Përqindja më e madhe e të anketuarve (59%) janë shprehur se parqet në lagjet e tyre nuk kanë kënd lojërash për fëmijë. Ndryshimi mes përgjigjeve të dy gjinive ka qenë i vogël. Të rinjtë dhe mesmosha janë shprehur më shumë për mungesën e këndeve të lojërave.

## 7. A JANË TË MJAFTUESHME DHE TË MIRËMBAJTURA ULËSET NËPËR PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE?


5



### PËRMBLEDHJE:

Shumica e të anketuarve (51%) vlerësojnë se nuk ka mjaftueshëm ulëse nëpër parqe dhe hapësira gjelbëruese, 42% janë shprehur se ka, mirëpo nuk mirëmbahen, ndërkaq vetëm 7% janë shprehur se ka mjaftueshëm ulëse. Gratë dhe burrat kanë menduar ngjashëm, me përqindjet mes përgjigjeve të tyre me ndryshime të vogla. Grupmoshat e rritura dhe më në moshë janë shprehur më shumë dhe ngjashëm për mungesën e ulëseve.

## 8. A MENDONI SE KA MJAFTUESHËM SHPORTA DHE KONTEJNERË PËR MBETURINA NË PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE DHE A MIRËMBAHEN NGA INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE ?




### PËRMBLEDHJE:


Shumica e të anketuarve e vlerësojnë shumë të nevojshme formimin e shtigjeve të biçikletave nëpër rrugët e qytetit të Prizrenit. Nga kjo përqindje, pjesa më e madhe janë qytetarët e moshave 19-34 vjeç me 60-65%, kurse shikuar nga gjinia gratë dhe burrat tregojnë një qëndrim të barabartë.



## TË PËRGJITHSHME




## GJINIA



## MOSHA

18-24 25-34 35-44 45-54 55-64 65+




## PËRMBLEDHJE:


52% e të anketuarve vlerësojnë se banorët e lagjes së tyre kujdesen ndonjëherë për mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe parqeve, ndërkohë që 40% janë përgjigjur negativisht në këtë pyetje. Burrat dhe gratë janë prononcuar ngjashëm, me dallim të vogël në përqindje. Më së shumti janë përgjigjur individë nga grupmosha 25-24 vjeç.

## 10. A MENDONI SE NDRIÇIMI NË PARQE DHE HAPËSIRA PUBLIKE ËSHTË I MJAFTUESHËM ?

## TË PËRGJITHSHME




## GJINIA



## MOSHA

18-24 25-34 35-44 45-54 55-64 65+




## PËRMBLEDHJE:

Nga të anketuarit 56% vlerësojnë se ndriçimi në hapësirat publike është deri diku i mjaftueshëm, 35% që nuk është i mjaftueshëm dhe vetëm 9% që është i mjaftueshëm. Gratë janë shprehur për një përqindje pak më të lartë se meshkujt dhe grupmosha 25-34 vjeç kanë qenë më të zëshëm.




## 11. A MENDONI SE PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE JANË TË SIGURTA PËR VAJZAT /GRATË ?



## PËRMBLEDHJE:

Statistikat e nxjerrura nga pyetësi për hapësirat publike shprehin se 46% të të anketuarve mendojnë se hapësirat publike janë deri diku të sigurta për vajzat/gratë, ndër ta burrat janë prononcuar më pozitivë, ndërkaq gratë më pak të bindura. Mesomosha janë prononcuar më shumë.


## 12. SA JANË TË QASSHME PARQET DHE HAPËSIRAT PUBLIKE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA ?



## PËRMBLEDHJE:

Sipas të të anketuarve, hapësirat publike në përgjithësi janë pjesërisht të qasshme për personat me aftësi të kufizuara (49%) dhe 40% janë shprehur se janë të qasshme vetëm me përcjellje. Burrat janë shprehur më shumë se janë pjesërisht të qasshme, ndërkohë që gratë janë shprehur më shumë se janë të qasshme vetëm me përcjellje. Grupmosha 25-24 vjeç kanë participuar më shumë në dhënien e përgjigjeve.


## 13. A EKZISTON RREZIKU NGA QENTË ENDACAK NË PARKUN E LAGJES DHE HAPËSIRA PUBLIKE ?



## PËRMBLEDHJE:

Në pyetjen se a ekziston rreziku nga qentë endacakë, ndryshimi në përgjigje ka qenë i ndjeshëm; 91% kanë pohuar se ekziston një rrezik i tillë, ndërkaq vetëm 9% kanë thënë se nuk ka rrezik nga ta. Burrat janë përgjigjur më shumë se një rrezik i tillë ekziston (51%), me gratë që kanë dhënë të njëjtën përgjigje që përbëjnë 41%. Grupmosha 25-34 përbën numrin më të madh të të anketuarve që e kanë pohuar ekzistencën e këtij problemi.

## 14. A JENI FTUAR NDOJËHERË NGA INSTITUCIONET KOMUNALE PËR TË DISKUTUAR DHE OFRUAR PROPOZIME RRETH HAPËSIRAVE GJELBËRUESE NË QYTET ?



## PËRMBLEDHJE:

88% e të anketuarve janë shprehur se nuk kanë marrë ftesë për të diskutuar dhe ofruar propozime për hapësirat gjelbëruese në qytetin e tyre dhe vetëm 2% kanë thënë se janë ftuar dhe kanë marrë pjesë. Ndër ta, dhënia e përgjigjeve ka qenë pothuajse në nivel të njëjtë mes grave dhe burrave. Si gjithmonë, grupmoshat më të reja kanë qenë më të zëshëm.

## REKOMANDIME

Hapësirat gjelbëruese janë pjesë thelbësore të një qyteti funksional. Institucionet lokale duhet të marrin parasysh shqetësimin e shprehur nga qytetarët e anketuar. Mungesa e hapësirave të gjelbra tregon që planifikimi hapësinor i qytetit të Prizrenit nuk është në përputhje me kërkesat dhe nevojat e banorëve. Studime të shumta kanë treguar që parqet sjellin përfitime sociale, mjedisore, ekonomike dhe shëndetësore për një qytet dhe njerëzit e tij.



Qytetarët e Prizrenit kanë deklaruar që në lagjet e tyre ka parqe mirëpo janë jofunksionale për shkak të gjendjes jo të mirë dhe mosmirëmbajtjes institucionale. Drejtoria përkatëse rekomandohet që të identifikojë nevojat e këtyre parqeve dhe të shtohet kujdesi institucional ndaj tyre në mënyrë që të jenë të shfrytëzueshme nga banorët. Poashtu, të ketë planifikime të përbashkëta me shfrytëzuesit e këtyre hapësirave në mënyrë që edhe qytetarët ta krijojnë ndjenjën e përkatësisë dhe të jenë më të vëmendshëm ndaj atyre që i dëmtojnë këto parqe.



Duke qenë se grupet e marginalizuara dhe pleqtë deklarohen si frekuentuesit më të paktë të parqeve atëherë komuna duhet të krijojë kushte më të përshtatshme për këto grupe duke u bazuar në standardet e planifikimit të hapësirave publike për këto kategori. Poashtu rekomandohet që komuna të krijojë kënde të lojërave për fëmijë në parqet e qytetit në mënyrë që të funksionalizohen këto hapësira dhe njëkohësisht rekomandohen qytetarët që të jenë më vigjilent ndaj dëmtuesve dhe të raportojnë personat tek organet e rendit.



Komuna rekomandohet të identifikoj numrin e ulëseve të dëmtuara dhe atyre që mungojnë dhe në bazë të një planifikimi që do të dal nga ky inventarizim të vendosen ulëset e reja në këto parqe. Nga qytetarët e anketuar ka dal si shqetësim edhe mosmirëmbajtja e kontejnerëve dhe ndriçimi jo i mirë. Andaj rekomandojmë komunën që të ketë më shumë koordinim me eko-regjionin në mënyrë që të kemi hapësira më të pastra dhe të shtohet numri i tyre aty ku cilësohet si e nevojshme nga banorët. Poashtu rritja e kualitetit të ndriçimit apo dhe rritja e sasisë së ndriçuesve nëpër hapësira të nevojshme do të ndihmonte dukshëm në zbutjen e problemeve që shkaktohen nga mungesa e ndriçimit publik.



## REKOMANDIME



Duke qenë se statistikat e këtij hulumtimi tregojnë që qytetarët nuk janë duke u kujdesur për parqet atëherë komuna rekomandohet që gjatë fazës së projektimit të parqeve të aplikojë metodologjinë e publikuar nga EC siç është planifikimi me pjesëmarrje qytetare. Praktikant ndërkombëtare tregojnë se aplikimi i kësaj metodologjie të dizajnit i bën qytetarët ta ndjejnë hapësirën publike si të mirë të përbashkët dhe në këtë mënyrë e shtojnë kujdesin dhe mirëmbajtjen ndaj saj.



Autoritetet e sigurisë dhe rendit në nivel komunal duhet të aktivizohen më shumë për çështjen e sigurisë së grave dhe vajzave në hapësira publike dhe parqe në Prizren. Aplikimi i fushatave të ndryshme vetëdijesuese kundër ngacmimeve të vazhdueshme, do të ndikonte në përmirësimin e raportit të tyre me qytetin, duke krijuar ndjesinë e lëvizjes së lirë dhe qëndrimit të pakusht në hapësirat që u takojnë të gjithëve.



Personat me Aftësi të Kufizuar në Kosovë në përgjithësi dhe në Prizren në veçanti përballen me diskriminimin shumëdimensional në baza ditore. Komuna duhet të zbatojë hapa të përgjithshëm për të siguruar një qytet pa barriera dhe ti ofrojë komunitetit PAK një informatë shtesë për hapësirat në të cilat aktualisht mund të kenë probleme për qasje.



Planifikimi me pjesëmarrje siguron që asnjë nga grupet e komuniteteve të mos jenë të përjashtuara nga zhvillimet në shoqëri, meqë hapësira e ndërtuar falë procesit të tillë, promovon lëvizje të lirë, zhvillim, punësim, arsim dhe në përgjithësi barazi sociale.

## Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

**1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
- 4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.